



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2149 Prot.

Lezhë, më 24 . 12 . 2021

VENDIM

Nr. 172 Datë 23 . 12 . 2021

Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2021

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr.21918/3, datë 07.12.2021 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.34, datë 03.12.2021”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e një shtese në buxhetin e bashkisë për vitin 2021, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2021 në shumën 20,221,458 lekë.

1/2-Të shtohen shpenzimet në programet buxhetore si më poshtë:

- Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.602 për shumën 5,285,509 lekë, e konkretisht : për likuidim të detyrimeve të prapambetura për shërbimin postar në shumën 725,145 lekë, ujë të pijshëm në shumën 4,008,364 lekë dhe karta telefonike në shumën 552,000 lekë.
- Gr.00, Prog.04520, Kap.01, Art.231 për shumën 14,935,949 lekë, e konkretisht : për likuidim të detyrimeve të prapambetura për investime për objektet : Sistemim, asfaltim Blloku “Besëlidhja” në shumën 4,159,444 lekë; Sistemim, asfaltim rruga Rraboshtë – Shkolla 9 vjeçare në shumën 3,993,600 lekë; Sistemim, asfaltim rruga e shkollës, lagjja e Pukjanëve fshati Grykë Lumi në shumën 5,912,173 lekë dhe Mbikqyrje punimesh në shumën 870,732 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

